



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 128, datë 28.10.2021

PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 1.524.086 LEKË AKORDUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR GRANTIN E
MENJËHERSHËM, PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË ULJE TË VLERËS SË
KONTRATËS

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKB-së nr. 630, datë 11.10.2019 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 6.037.194 lekë, akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për grantin e menjëhershëm, sipas listës së familjeve të cilat kanë kontratë me Entin Kombëtar të Banesave të cilët përfitojnë ulje të vlerës së kontratës”, VKM-së nr. 555, datë 15.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe përparsitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga Buxheti i Shtetit”, Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.773/33 prot, datë 24.03.2021, protokolluar me tonën nr.3768 prot., datë 26.03.2021, Shkresës nr. 773/35 prot., datë 29.03.2021, protokolluar me tonën nr. 4027 prot., datë 30.03.2021 dhe sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Strehimit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 1.524.086 lekë, akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për grantin e menjëhershëm, për familjet që përfitojnë ulje të vlerës së kontratës.

2. Fondi prej 1.524.086 lekë, do të përdoret për uljen e vlerës së kontratës për çdo familje përfituese sipas tabelës bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Drejtoria Ekonomike ngarkohet të kryejë procedurat për kalimin e fondit në llogari të Entit Kombëtar të Banesave si dhe Bankës Kombëtare Tregtare.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.10.2021




Lista e familjeve që përfitojnë nga granti i menjëhershëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nr.Fa milje	EMER/MBIEMER	VKB që e ka miratuar	Statusi (I Verbër, PAK, jetim)	Vlera e Kontratës totale	Vlera e kështit mujor	% e Grantit nga Buxheti	Vlera e grantit që përfiton
1	Irena Josuf HYSA	VKB Nr.200 dt.24/2/2010-EKB	b. PAK	2242032	9502.95	granti 10 %	224203.2
2	Nevruz Rexhep ROHANI	VKB Nr.200 dt.24/2/2010-EKB	Anëtar i kom. Egjiptian e ve	2316548	51700	granti 10 %	231654.8
3	Fatbardha Sherif BUSHI	VKB Nr.200 dt.24/2/2010-EKB		2298660	9742.97	granti 10 %	229866
4	Pavlin Agim KAVAJA	VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB	b. PAK	1803832	12457	granti 10 %	180383.2
5	Nertila Nexhip QATO	VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB	b. PAK	1717118	11858.1	granti 10 %	171711.8
6	Petrit Besim BERHAMAJ	VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB	b. PAK	2619845	18092.17	granti 10 %	261984.5
7	Ded Ndreja KONIKA	VKB Nr.594 dt.11/03/2019-EKB	b. PAK	2242826	22170.97	granti 10 %	224282.6
	TOTALI						1524086.1

TOTALI I GRANTIT TE MENJEHERSHEM..... 1 524 086 leke





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 868/prot.
5

Durrës, më 04.11.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.128 datë 28.10.2021 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 1.524.086 lekë akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për grantin e menjëhershëm për familjet që përfitojnë ulje të vlerës së kontratës”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

